



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
ASAMBLEJA

Prot 837

Tiranë, 16.11.2023

Vendim nr. 62 datë 16.11.2023

Për dhënien e titullit *anëtar nderi* të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë prof. dr. Ke Jing, profesore, *doktore e shkencave në albanologji (Louisville University, SHBA)*, studiuese e gjuhës shqipe, letërsisë dhe identitetit shqiptar; përgjegjëse e katedrës së shqipes në Universitetin e Gjuhëve të Huaja në Pekin (BFSU); drejtore për marrëdhëniet me jashtë në BFSU; drejtore e Institutit të Studimeve për Europën në BFSU; drejtuese projektesh të rëndësishme në albanologji dhe përkthyes

Mbështetur në nenin 6 pika 3 të Ligjit 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;

Referuar nenit 12 pika 1 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe nenit 12 të *Aneksit II*, pika 5 të tij;

Propozuar anëtarëve të Asamblesë nga Kryesia me vendimin nr. 67, datë 18.11.2021 (bashkëngjitur); mbështetur në letrat e referencës të dy anëtarëve të saj, akad. Floresha Dado dhe akad. Shaban Sinani, njohës të drejtpërdrejtë të veprimtarisë së kandidatës (bashkëngjitur);

Pasi u mor mendimi i anëtarëve të dy seksioneve të Akademisë së Shkencave, sipas rendit të parashikuar në pikën 3 të nenit 12 të Statutit, dhe u konfirmua vullneti i saj me shprehje mendimi sipas procedurave statutore për vendimet qarkulluese (procesverbali bashkëngjitur);

Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

## Vendosi

1. T'i japë titullin *anëtar nderi* të kësaj Akademie studiueses Ke Jing, profesore dhe *doktore e shkencave në albanologji* (Louisville University); studiuese e mirënjohur në gjuhësi, antropologji, letërsi e identitet; drejtuese projektsh themelore për njohjen e përrurimin e trashëgimisë shqiptare në vendin e saj dhe në Botë, me këtë

## Motivacion

Albanologe e mirënjohur, me studime të thelluara cilësore në çështje të historisë së letërsisë, të gjuhës, të kulturës e të identitetit shqiptar; nismëtare e drejtuese e suksesshme projektsh shkencorë dhe kulturorë për njohjen dhe përrurimin e trashëgimisë së qytetërimit shqiptar në vendin e saj dhe në një shkallë më të gjerë; figurë qendrore e studimeve shqiptare në Kinë dhe autore referenciale për çështje të karakterit të ekspertizës albanologjike; me një rol vetjak shumë të rëndësishëm për paraqitjen sistematike dhe me realizëm e përgjegjësi të arritjeve, vlerave dhe meritave të shkollës kineze të studimeve shqiptare në mjedisë ndërkombëtare; profesore e drejtuese kërkimesh në shkallë të formuesit të specialistit në albanologji; përkthyesë e editore pasionante dhe mike e botës shqiptare.

2. Ceremonia e dorëzimit të diplomës së *anëtarit të nderit* të organizohet më datën 16.11.2023, në përputhje me pikën 4 të nenit 12 të Statutit.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

